



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0098

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “TOREX GROUP” L.L.C., kundër vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit të “KOMUNA LIPIJAN” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor – RITENDERIM” me numër të prokurimit 613-24-13533-2-2-1, me 26/03/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “TOREX GROUP” L.L.C. me nr. 2025/0098, e datës 06/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor – RITENDERIM” me numër të prokurimit 613-24-13533-2-2-1.

2. Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të “KOMUNA LIPIJAN”, ndërkah aktiviteti i prokurimit “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor – RITENDERIM” me numër të prokurimit 613-24-13533-2-2-1 kthehet në **Rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “TOREX GROUP” L.L.C.

5. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimin të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 30.12.2024, "KOMUNA LIPIJAN" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor – RITENDERIM" me nr. të prokurimit: 613-24-13533-2-2-1. Ndërsa me datën 24.01.2025 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 €.

Me 28.01.2025, OE "TOREX GROUP" L.L.C ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 29.01.2025, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06/02/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "TOREX GROUP" L.L.C me nr. 2025/0098 për lidhur me aktivitetin "Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor – RITENDERIM" me nr. të prokurimit: 613-24-13533-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "TOREX GROUP" L.L.C janë parashtruar si në vijim:

Sipas Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje ligjore:

Pretendimi 1:

Duke u bazuar ne vendimin e AK-se te datës 24.01.2025 mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit ku deklarohet se ne si OE jemi eliminuar me arsyetimin se nuk kemi ofruar kontrata për projekte të ngjashme ne vlere prej 100,000.00 € ne tri vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate.

Arsyetimi i Ak-se për eliminim vazhdon me: Gjate kontrollimit të dokumenteve tuaja ju ne listën tuaj keni paraqitur disa projekte si mirëmbajtje mes kompanisë tuaj dhe Komunës së Gjakovës dhe ne si AK të gjitha i kemi evidentuar ne platformën e prokurimit dhe kemi analizuar specifikimin e këtyre shërbimeve që ju i keni kryer por asnjëra nga këto kontrata nuk është e ngjashme me aktivitetin e Prokurimit të publikuar nga Komuna e Lipjanit dhe këtë kriter nuk e keni plotësuar siç ishte kërkuar në NJK dhe DT.

Ne si OE me oferte kemi dorëzuar një liste të projekteve ku ne të ka të përfshira kontrata të realizuara për mirëmbajtje të cilat sipas LPP-se dhe Rregulloreve në fuqi i plotësojnë kërkesat e AK-se.

Kërkesë e dosjes së tenderit është:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 100,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Dëshmia 1. Një listë e kontratave të nënshkruar dhe vëltur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat kopje për kontratat e prezantuara për projekte të ngjashme, Nëse kontrata me referencë është me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është kry pagesa). Referencat duhet të jenë në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë

Ne si OE kemi dorëzuar kontrata dhe referencat të cilat janë për mirëmbajtje sipas kriterëve të specifikuar në DT. Përkundër faktit se ne kemi dorëzuar kontratat ju si AK ne kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit keni kontrolluar specifikimet teknike të këtyre kontratave në mënyrë të kundërligjshme në sistemin e e-prokurimit të kontratat e publikuara nga AK-të vetëm e vetëm që të gjeni një arsye të paqenë që të na eliminoni ne si OE të vetmin të përgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.

Në kërkesën e FDT-së specifikohet qartë se dëshmi duhet të dorëzohen: “kontrata me titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës” dhe në asnjë rast nuk është specifikuar se dëshmi duhet të dorëzohet specifikimi teknik i çdo kontrate të dorëzuar por që ne kundërshtim me dosjen e tenderit dhe nenin 40.2 të RRPP 002/2024 AK e ka shtuar edhe një kërkesë shtesë.

Një gjë e tillë nuk është në përputhje me kërkesat e FDT-së sepse sipas kërkesave të FDT është kërkuar “kontrata të ngjashme” përderisa ju si AK e keni trajtuar kriterin si për kontrata të njëjta që është në kundërshtim me nenin 69 të LPP-së si dhe opinionin e KRPP-së si me poshtë:

Sipas opinionit të KRPP-së nr. 11 të datës 09.06.2023 Në kuptim të prokurimit publik: Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a punë të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi “të ngjashme” ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Prandaj bazuar në vlerësimin e AK-së sipas opinionit të KRPP-së kjo është: Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi).

Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kriterë të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para. Po ashtu ju përkujtojmë se titulli i kontratës është “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor” derisa në listën e projekteve të dorëzuara nga ne si OE i përgjegjshëm ka projekte të cilat janë për “mirëmbajtje” si projektet në numrin rendor 9, 13, 17, 25, 32 e të cilat nuk i keni trajtuar fare. Kjo bie ndesh me nenin 40.12 të RRPP 002/2024 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Si dhe 40.13 Komisioni vlerësues do të vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit. si dhe me nenin 59.2 dhe

70 te LPP-se. Ju si AK ne dosjen e tenderit ne sipas nenit 2.1 te FDT Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): 93000000-8.

Ne si OE i përgjegjshëm kemi ofruar te gjitha dëshmitë ne përputhje me kërkesat e FDT-se duke u bazuar edhe ne nenin 3.5 te UOPP 001/2023 për te cilin AK duke bere shkelje ligjore nuk kane marr mundin fare te kontrollojnë dëshmitë e dorëzuara por ne mënyrë te njëanshme duke kontrolluar dokumente te ngarkuara nga palët tjera ne sistemin e e-prokurimit, rrjedhimisht duke na eliminuar ne me arsyetime te cilat nuk kane asnjë mbështetje ne LPP apo ne rregullore.

Për raste te njëta qe janë trajtuar edhe nga OSHP mund te përmendim sqarimin e OSHP ne vendimin 2023/0377 ne te cilin është sqaruar se si duhet te merret parasysh kur është duke u vlerësuar kontratat e ngjashme qe sipas neve si OE ankues me oferte te përgjegjshme konsiderojmë se është vepruar ne kundërshtim me atë qe sqarohet nga PSH i OSHP-se dhe rrjedhimisht na diskriminojnë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “TOREX GROUP” L.L.C konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim Neni 1 Qëllimi, Nenin 7 të LPP-së, Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi, Neni 69 i LPP-së, Neni 40 RRPP 002/2024 Neni 59, 72 i LPP, Opinionin nr. 11 i datës 09.06.2023 e KRPP-së. Përfundimisht konsiderojmë se ju si AK keni vepruar ne kundërshtim me LPP-ne Nenin 7 dhe 59 si dhe ne kundërshtim me RRPP 002/2024 nenin 40 si dhe Nenin 59.2 dhe 72 te LPP-se dhe me veprimet e AK-se jemi diskriminuar ne si OE te vetmin me oferte te përgjegjshme dhe kerkojme qe OSHP të: APROVOJË Ankesën dhe te anuloj NJOFTIM MBI ANULIMIN E AKTIVITETI TE PROKURIMIT. Ta kthej lenden ne rivlerësim dhe ta vlerësojë aktivitetin e prokurimit ne përputhje me LPP-ne dhe RRPP 002/2024 dhe rrjedhimisht te na shpalle fitues neve si OE te vetëm me oferte te përgjegjshme.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Përgjigje për pretendimin tuaj te parë: Kërkesë e AK ka qene: kontrata Një liste e kontratave e nënshkruar dhe vulosur nga OE ku do të behet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat kopje për kontratat e prezantuara për projekte te ngjashme, Nëse kontrata me reference është me kompani private te dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi qe është kry pagesa). Referencat duhet te jene ne 3 (tri) vitet e fundit, duke fluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë,

Duhet te ju njoftojmë qe shërbimet ndahen ne disa lloje, neve kemi pasur te bëjmë me mirëmbajtje te parkingut nëntokësor ne Qytetin e Lipjanit dhe po ju përshkruajmë edhe specifikimin teknik:

Për mirëmbajtjen e parkingut çdo ditë duhet të jenë minimumi 2 punëtorë 24 orë në ditë. Punëtoret te jenë të veshur me uniforma me llogo te kompanisë kontraktuese. Orari punës 24/7.

Për ditët që i nevojiten kontraktuesit për përfundimin e punëve dhe do të mbyllet parkingu, kontraktuesi do të paguhet 50% të vlerës për ato ditë sa do të jetë parkingu i mbyllur. Kjo do të llogaritet shuma e ofertuar për një muaj duke e pjesëtuar me 30 ditë

Detyrat:

1.Mbikëqyrje pastrimi i parkingut për të qenë funksional 24orë 7ditë në javë

2.Pastrimi i parkingut për çdo ditë nga mbeturinat që i lënë qytetarët gjatë qarkullimit në parking, pastrimi nga balta që e shkaktojnë veturat .Pastrimi nga mbeturinat që do të shkaktoheshin nga aksidentet

eventuale.

3. Menaxhim i veturave ne parking (drejtimi i shoferëve në rast të bllokimit nga drejtimi i pa kujdesshëm i ndonjërit nga shoferët).

4. Automjeti nuk mund të qëndroj me shume se 24 ne parking, ne rast se një automjet qëndron me shume se 24 ore ne parking, kompania kapër obligim të largon automjetin nga parkingu dhe ta barte deri ne parking të kontraktuesit, në rast se automjeti që duhet të tërhiqet nuk ka mundësi të tërhiqet atëherë do të përdoren bllokadat e rrotave.

5. Me rastin e tërheqjes apo kërkesë për zhbllokim të automjetit shoferi është i obliguar të paguaj tarifën e kontraktuesit e cila do të jetë e përshkruar në kontratë sipas tarifës që është caktuar me rastin e ofertimit nga kontraktuesi.

6. Mirëmbajtja e wc-ve. me rastin e funksionimit të wc-ve kontraktuesi është i obliguar që ti pastrojë minimumi 2 herë në ditë, ndërsa deri sa nuk janë funksionalë wc-të duhet të mbikëqyren që mos të përdoren nga qytetarët dhe nëse veq janë përdorur duhet të pastrohen.

7. OE për shërbimet e kryera nuk ka të drejtë të inkasoj të hyra apo të aplikoj ndonjë taksë nga qytetarët për azitomjetet e parkuara, kontraktuesi do të paguhet vetëm sipas përshkrimit të çmimeve. (përjashtimisht pikës 5) Komisioni për vlerësim të ofertave ka analizuar listën tuaj të projekteve dhe referencat që ju keni paraqitur ne dokumentacionin tuaj, ne listën tuaj janë disa projekte që me titull janë rregullime dhe mirëmbajtje, riparime dhe mirëmbajtje etj që ka të bëjë me shkolle dhe - varreza etj, dhe-ne si komision i vlerësimit duke analizuar përshkrimin-e këtyre referencave ishim ne dyshim se qfar lloje mirëmbajtjesh kane të bëjnë këto referenca duke u bazuar ne të dhënat e këtyre kontratave ne kemi gjetur te gjitha ne platformën e prokurimit kur siç e dini edhe ju te gjitha janë publike dhe kemi analizuar specifikimin e këtyre kontratave dhe ne te gjitha ato qka keni paraqitur ju nuk kane të bëjnë fare me kontratën te cilën ne e kemi te publikuar, një përshkrim i shkurtër për përmbajtjen e kontratave që ju keni paraqitur, kanë të bëjnë me furnizim dhe ndërrim të poqave furnizim dhe ndërrim të laminatit furnizim dhe montim të keramikës etj etj, dmth asnjë nga kontratat e paraqitura nuk ka të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit, edhe një her duhet te ju njoftojmë që mirëmbajtjet janë disa lloje që kete mund te analizoni edhe vete ju si OE. Pretendimet tuaja janë te Pa Bazuara. AK ka zbatuar me për pikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 10.02.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0098/2025, ndërsa me datë 22.02.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 0098/2025 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk ka dhe përgjigje rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet rreth raportit të ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te neni 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtrësat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të

mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertës, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “TOREX GROUP” L.L.C eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0098 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjet e ekspertit lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues:

Pretendimi Ankimor 1: Duke u bazuar në vendimin e AK-se të datës 24.01.2025 mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit ku deklarohet se në si OE jemi eliminuar me arsyetimin se nuk kemi ofruar kontrata për projekte të ngjashme në vlerë prej 100,000.00 € në tri vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrate.

Arsyetimi i AK-se për eliminim vazhdon me: Gjate kontrollimit të dokumenteve tuaja ju në listën tuaj keni paraqitur disa projekte si mirëmbajtje mes kompanisë tuaj dhe Komunës së Gjakovës dhe në si AK të gjitha i kemi evidentuar në platformën e prokurimit dhe kemi analizuar specifikimin e këtyre shërbimeve që ju i keni kryer por asnjëra nga këto kontrata nuk është e ngjashme me aktivitetin e Prokurimit të publikuar nga Komuna e Lipjanit dhe këtë kriter nuk e keni plotësuar siç ishte kërkuar në NJK dhe DT.

Sqarimi i ekspertit në pretendimin ankimor 1:

Kërkesa në dosje të tenderit në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1 është:

Kërkesa 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë prej 100,000.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë

Dëshmia 6. Një listë e kontratave të nënshkruar dhe vëlosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat kopje për kontratat e prezantuara për projekte të ngjashme, Nëse kontrata me reference është me kompani private të dëshmohet me transaksion bankar (dëshmi që është krye pagesa). Referencat duhet të jenë në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë.

Dëshmia e paraqitur nga OE ankues për këtë pretendim është:

OE ankues ka paraqitur listën e kontratave të nënshkruara me një numër të caktuar të kontratave për mirëmbajtje të shkollave, mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve të KPSH-së, renovime të ndryshme etj. Po ashtu janë bashkangjitur dy kontrata dhe referenca që kanë të bëjnë me rregullimin dhe mirëmbajtjen e shkollave në Komunën e Gjakovës. Me gjerësisht në lidhje me këtë mund të ju referoni fajllit në dosje të tenderit me numër rendor 15,16,17.

Eksperti shqyrtues sqaron se ne lidhje me ketë pretendim ankimor KRPP ka nxjerr opinionin me datë 09.03.2023 si ne vijim:

11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve “të njëjta” dhe “të ngjashme” në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?

Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

OPINION

Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.

Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.

Në kuptim të prokurimit publik:

Termi "njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi “të ngjashme” ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Shembull: Lënda e Kontratës “Furnizim me mollë”. Nëse AK kërkon si dëshmi ” Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro”. Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatorët ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).

Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshtrohet si në vijim: “Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara.....” Pra, nuk përmendet asnjëri nga termat “të njëjta” apo “të ngjashme”.

Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t’i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: “Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në kë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne ofertën e OE ankues , dëshmitë e ofruara ne lidhje me këtë pretendim ankimor, po ashtu bazuar ne opinionit e KRPP-së ku përcaktimi Termi “të ngjashme” ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, po ashtu gjithmonë duke u bazuar ne opinionin e KRPP-se se “, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t’i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.

Andaj duke u bazuar ne përshkrimin e mësipërm, marrë për bazë në përgjithësi opinionin e KRPP-së, nenin 6,7,59, 69 te LPP-së, ofertën e OE ankues konstatojmë se pretendimi ankimor nr. 1 i OE ankues është i bazuar sepse referencat e lëshuara dhe kontratat kanë të bëjnë edhe mirëmbajtjen e objekteve ne këtë rast te shkollave dhe mendojmë qe e plotësojnë kriterin e punëve te ngjashme sipas kërkesës se AK-KUVENDI KOMUNAL LIPJAN te përcaktuar ne dosje te tenderit.

Përmbyllja e Ekspertizës

Duke u bazuar në analizën, krahasimet, shqyrtimet e pretendimeve ankimore, dosjes se tenderit, ofertës se OE ankues, si dhe rrjedhës së përgjithshme të këtij aktiviteti të prokurimit publik, eksperti shqyrtues i propozoni Panelit Shqyrtues të OSHP-së që ankesa është e bazuar dhe te anulohet vendimi i AK-së i datës 24.01.2025 mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit, dhe lënda të kthehet në rivlerësim për arsyet e lartcekura. Rekomandojmë panelin shqyrtues qe ankesa te konsiderohet e bazuar Te anulohet vendimi i AK-se i datës 24.01.2025, mbi anulimin e aktivitetit te prokurimit. Te kthehet lënda në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim, dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor – RITENDERIM” me nr. të prokurimit: 613-24-13533-2-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TOREX GROUP” L.L.C dhe se argumentimi në raportin e ekspertës është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertës mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka fatur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “TOREX GROUP” L.L.C janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Mirëmbajtja e parkingut nëntokësor – RITENDERIM” me nr. të prokurimit: 613-24-13533-2-2-1, të anulohet njoftimi për anulim dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim. dhe AK të veproj në harmoni me rekomandimet e ekspertëve shqyrtues, ngase sipas gjykimit të këtij Paneli Shqyrtues dhe në mbështetje të përgjigjeve të dhëna në raportin e ekspertit shqyrtues, konsideron se duke u nisur edhe nga përshkrimi i shrëbimeve që do të bëhet me këtë kontratë nuk dallon fare me llojin e kontratave të realizuara të cilat ankuesi i ka paraqitur në ofertë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - TOREX GROUP L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: